REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË
KOLEGJI CIVIL

Nr. 11243-01664-00-2013 i Regj. Themeltar
Nr. 00-2016 - 240 i Vendimit (16)

V E N D I M

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë i përbërë nga:

Ardian NUNI	**Kryesues**
Aleksandër MUSKAJ	**Anëtar**
Artan BROCI	**Anëtar**

në seancën gjyqësore të datës 21.01.2016 mori në shqyrtim çështjen civile me Nr. 01664/13, që u përket palëve:

KËRKUESE: **SHOQËRIA "VANA TALLINN LINE" LTD**
(në mungesë)

OBJEKTI: *Njohjen e vendimit të Gjykatës së Arbitrazhit të Huaj.*

BAZA LIGJORE: *Ligji nr. 8688, datë 09.11.2000 "Për aderimin e RSH në Konventën për Njohjen dhe Zbatimin e Vendimeve të Huaja të Arbitrazhit" (Konventa e Neë York-ut 1958); nenet 123 dhe veçanërisht nenet 4 dhe 5 të Konventës së sipërcituar.*

Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr.18, datë 29.04.2013, ka vendosur:
"Rrëzimin e kërkesës së kërkuesit Shoqëria Vana Tallinn Line Ltd".

Kundër vendimit të Gjykatës së Apelit Durrës, ka ushtruar rekurs shoqëria "Vana Tallin Line" Ltd, me të cilin kërkon ndryshimin e vendimit të gjykatës së apelit dhe pranimin e kërkesës, për këto shkaqe:

- Vendimi nr. 18, datë 29.04.2013 i Gjykatës së Apelit Durrës ka shkelje të rënda të ligjit procedural dhe material. Është kryer një interpretim i gabuar i Konventës për Njohjen dhe Ekzekutimin e Vendimeve të Huaja të Arbitrazhit dhe i Kodit të Procedurës Civile. Sipas këtyre akteve kusht për njohjen e vendimit të gjykatës së arbitrazhit të huaj është që vendimi të jetë i formës së prerë dhe jo domosdoshmërisht përfundimtar.

- Neni 5 i ligjit nr.8688, datë 09.11.2000 "Për aderimin e RSH në Konventën për njohjen dhe zbatimin e vendimeve të huaja të Arbitrazhit", përcakton rastet kur njohja e vendimit të gjykatës së arbitrazhit mund të refuzohet nga gjykata dhe në rastin konkret nuk jemi para ndonjërit prej këtyre rasteve.

- Neni 394 i K.Pr.Civile përcakton pengesat ligjore për zbatimin e vendimeve të dhëna nga gjykatat e huaja dhe vetë gjykata e apelit në vendimin e saj nuk përmend ndonjë prej rasteve për të cilat pengohet njohja e vendimit të arbitrazhit të huaj.

- Vendimi i gjykatës së apelit nuk respekton standartin kushtetues të arsyetimit të vendimeve gjyqësore. Në gjykim nga ana e kërkuesit janë ngritur një sërë pretendimesh në lidhje me arsyet se përse kërkesa duhet pranuar dhe gjykata e apelit në vendimin e saj nuk i është përgjigjur këtyre pretendimeve.

- Gjykata e Apelit Durrës në asnjë moment të vendimit nuk ka arsyetuar se përse vendimi i Gjykatës së Arbitrazhit Londër nuk është përfundimtar në kuptim të ligjit shqiptar.

KOLEGJI CIVIL I GJYKATËS SË LARTË

pasi dëgjoi relatimin e gjyqtarit Ardian Nuni, dhe si bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N

RRETHANAT E ÇËSHTJES:

1. Nga materialet e dosjes gjyqësore rezulton se shoqëria "Vana Tallinn Line" LTD, është një shoqëri tregtare e të drejtës qipriote, me seli në Nicosia, Qipro dhe e ushtron aktivitetin e saj në fushën e transportit detar. Kjo shoqëri është pronare e tragetit "Adriatica Queen".

2. Në kuadër të ushtrimit të aktivitetit të saj, me datë 25.05.2011, kjo shoqëri ka lidhur me shoqërinë "Allferries" sa, me seli në ishujt Marshall, kontratën "Bareboat Charter" në lidhje me tragetin "Vana Tallinn", i cili tashmë quhet "Adriantica Queen".

3. Duke pretenduar mosfunksionimin e kësaj kontrate, rekursuesi e ka zgjidhur këtë kontratë në mënyrë të njëanshme dhe me datë 07.12.2012 i është drejtuar Shoqatës së Arbitrave Detarë në Londër, me një kërkesë për arbitrim, kundër shoqërisë "Allferries" sa.

3.1. Gjatë gjykimit të arbitrazhit, kërkuesi i ka kërkuar Gjykatës së Arbitrazhit marrjen e masës së sigurimit të padisë, në mënyrë që të ketë të drejtën e marrjes në posedim të anijes nga "Allferries" sa.

4. Gjykata e Arbitrazhit, me vendim të ndërmjetëm të datës 22.01.2013, ka vendosur: *"Deklarojmë vendimin për masën e sigurimit të formës së prerë si vijon: (i) Deklarojmë se paditësit kanë të drejtë të rimarrin në dorëzim anijen Vana Tallinn tashmë të quajtur "Adriatica Queen", një traget për pasagjerë me Numër IMO 7329522, nga të padituri në*

portin në të cilin ndodhet aktualisht, pa pengesa apo ndërhyrje nga të padituri, gjykatat ose autoritetet vendase. (ii) Dhe kemi lënë për të shqyrtuar më tej të gjitha pyetjet që kanë lindur lidhur me këtë çështje, përfshirë të gjitha pyetjet lidhur me detyrimin përfundImtar për të gjitha shpenzimet në lidhje me këtë vendim të ndërmjetëm të formës së prerë që është dhënë veçmas si dhe kostot e palëve lidhur me këtë vendim."

5. Kërkuesi Shoqëria "Vana Tallinn Line" LTD, i është drejtuar Gjykatës së Apelit Durrës për të njohur këtë vendim dhe për të siguruar ekzekutimin e tij në Republikën e Shqipërisë, bazuar në legjislacionin shqiptar, me qëllim që të lejohej kërkuesi të merrte fizikisht posedimin e anijes, e cila ndodhej e ankoruar në Portin Detar në Durrës.

6. Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. 18, datë 29.04.2013, ka rrëzuar kërkesën e shoqërisë "Vana Tallinn Line" Ltd.

6.1. Në rrëzimin e kërkesës gjykata e apelit arsyeton: - "*Gjykata e Arbitrazhit të Huaj Londër, me datë 22.01.2013 ka shpallur vendimin e ndërmjetëm të formës së prerë me kreditor kërkuesin "Vana Tallin Line" LTD*"; - *"Ky vendim i ndërmjetëm i Gjykatës së Arbitrazhit të Huaj Londër, rezulton të mos jetë përfundimtar dhe si i tillë bazuar në nenin 399 të K.Pr.Civile nuk mund të njihet nga gjykatat e apelit të Republikës së Shqipërisë"*; - *"Njohja e vendimeve të arbitrazhit të një shteti të huaj bëhet vetëm për vendimet përfundimtare sipas legjislacionit të brendshëm shqiptar. Gjithashtu edhe aktet ndërkombëtare në të cilat rezulton të ketë aderuar Republika e Shqipërisë lejojnë njohjen e vendimeve të një arbitrazhi të huaj i cili është përfundimtar, përfshirë edhe Konventën e New York-ut vitit 1958, të përdorur si bazë ligjore nga kërkuesi në këtë kërkesë"*.

7. Kundër vendimit të Gjykatës së Apelit Durrës, ka ushtruar rekurs shoqëria "Vana Tallin Line" Ltd, me të cilin kërkon ndryshimin e vendimit të gjykatës së apelit dhe pranimin e kërkesës, për shkaqet e pasqyruara në pjesën hyrëse të këtij vendimi.

LIGJI I ZBATUESHËM

8. Dispozitat e Kodit të Procedurës Civile në të cilat është parashikuar:

8.1. Neni 490 i K.Pr.Civile: *"Pala mund të heq dorë nga rekursi derisa nuk është filluar relatimi në seancë gjyqësore. Heqja dorë bëhet me shkrim, e nënshkruar nga vetë pala apo avokati i saj, i pajisur me prokurë për këtë qëllim.*
Akti i heqjes dorë u njoftohet palëve që janë paraqitur ose u komunikohet avokatëve të palëve.
Kur hiqet dorë nga rekursi dhe në gjykim kanë marrë pjesë të gjitha palët ose përfaqësuesit e tyre, nuk ka vend për shpallje të veçantë të vendimit të pushimit të gjykimit".

KOLEGJI CIVIL I GJYKATËS SË LARTË VLERËSON

9. Se ndodhemi përpara kushteve ligjore kur duhet të vendoset pushimi i gjykimit të çështjes në Gjykatën e Lartë.

10. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë evidenton se nga Avokati Alban Çaushi, përfaqësues me prokurë i shoqërisë "Vana Tallin Line" Ltd të datës 09.01.2014, ka paraqitur kërkesë më datën 16.01.2014 pranë Gjykatës së Lartë, protokolluar në nr. SH-20 Prot., datë 16.01.2014, në të cilën parashtrohet: *(i) "Duke qenë se mosmarrëveshja ndërmjet palëve është zgjidhur në themel të saj, Kërkuesi kërkon të heqë dorë nga Rekursi"; (ii) "Sa më sipër, bazuar në Nenin 490 të KPrCivile, Kërkojmë: - Pranimin e Kërkesës "mbi heqjen dorë" nga Gjykimi i Çështjes Civile nr. 11243-01664-00-2013; - Pushimin e Gjykimit në Gjykatë të Lartë"*.

10.1. Kërkesës i bashkëngjiten: *(i)* fotokopje e letërnjoftimit ID nr. 026564647 të nënshkruesit të kërkesës për heqje dorë nga rekursi, avokatit; *(ii)* licensa e avokatit Alban Çaushi nr. 891; *(iii)* origjinali i Prokurës së Përgjithshme datë 09.01.2014 me Apostille (Konventa e Hagës e 01.10.1961), vulosur dhe nënshkruar në emër të shoqërisë "Vana Tallinn Line" Ltd nga nga Katia Constantinou, Drejtore Zëvendësuese dhe Katerina Iosif, Drejtore Zëvendësuese për Janek Stalmeister, në gjuhën angleze dhe të vërtetuar nënshkrimin e përkthyeses me vërtetimin noterial nr. 110 Rep. Janar 2014.

11. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë e vlerëson kërkesën e sipërcituar në pajtim me kushtet e parashikuara nga neni 490 i Kodit të Procedurës Civile, që përcakton se: *"Pala mund të heqë dorë nga rekursi derisa nuk është filluar relatimi në seancë gjyqësore. Heqja dorë nga rekursi bëhet me shkrim e nënshkruar nga vetë pala ose avokati i saj i pajisur me prokurë për këtë qëllim...."*.

12. Rezulton që kjo kërkesë është paraqitur me shkrim, është nënshkruar nga avokati i pajisur me prokurë dhe është paraqitur përpara se të fillojë relatimi i çështjes në seancë gjyqësore. Nga përmbajtja e prokurës del se i përfaqësuar, shoqëria "Vana Tallin Line" Ltt, i cilësuar "Autorizuesi", me seli në 15, Them. Dervis Ave, Margarita House, 1066, Nikosia, Qipro ka caktuar *"Z. Alban Çaushi, Endri Jorgoni dhe Z.Terens Kurti, avokatë të zyrës ligjore Kalo&Associates në Shqipëri, të cilët së bashku ose veçmas kanë të drejtë të përfaqësojnë Autorizuesin në Shqipëri...kanë të drejtë të ngrenë dhe të nënshkruajnë kërkesa, ankime, ankesa administrative, drejtuar..., Gjykatave Shqiptare në çdo shkallë,...ose të ndërmarrin të gjitha hapat e nevojshme për të nënshkruar çdo kërkesë lidhur me tërheqjen e Ankimit në Gjykatën e Lartë të Shqipërisë kundër vendimit të Gjykatës së Apelit Durrës Nr. 18, datë 29.04.2013 "për njohjen e vendimit të gjykatës së huaj të arbitrazhit. Kjo Prokurë e Përgjithshme është e kufizuar vetëm për qëllimin e mësipërm"*.

13. Në vështrim të nenit 490 të Kodit të Procedurës Civile, ky kolegj vlerëson se këto akte përbëjnë heqje dorë të kësaj pale nga rekursi që ka paraqitur kundër vendimit nr. 18, datë 29.04.2013 të Gjykatës së Apelit Durrës.

14. Akti e heqjes dorë nga rekursi, është nënshkruar nga avokati i palës rekursuese i pajisur me prokurë për këtë qëllim.

15. Në këto rrethana, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë vlerëson se, në kuptim të dispozitave të sipërcituara, duhet të vendoset pushimi i gjykimit të çështjes civile nr. 11243-01664-00-2013 në këtë gjykatë.

PËR KËTO ARSYE

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë mbështetur në nenet 490 dhe 491 të Kodit të Procedurës Civile.

V E N D O S I

Pushimin e gjykimit të çështjes civile nr. 11243-01664-00-2013 në Gjykatën e Lartë.

Tiranë, më 21.01.2016

A N Ë T A R	**A N Ë T A R**	**K R Y E S U E S**
Aleksandër MUSKAJ	**Artan BROCI**	**Ardian NUNI**

Vërtetohet njësia me origjinalin P.Adm.Gjyq. D.Qerimi F.M.